

NR.PROT 432/1, DATE 25.09.2022

NJOFTIM PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT/AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV KU DO TË KETË VENDNDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR T'U PAJISUR ME LEJE MJEDISI TË INSTALIMIT TË TIPIT A OSE B / NDRYSHIME NË FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË TIPIT A DHE B

Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, të ndryshuar, Ligjin Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” të ndryshuar, Ligjin Nr. 52/2020, datë 30.04.2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” të ndryshuar dhe VKM 419 nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” të ndryshuar, Kreu VI “Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B”, pika 2, Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për “Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B” apo “Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B”; *Aplikim për ndryshimin e kushteve të lejes së mjedisit të tipit A, PN-8683-05-2019*
2. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së; *Shoqëria “ECO RICIKLIM” Sh.p.k, NIPT: L61814009B*
3. Adresën e vendndodhjes së instalimit; *Bashkia Elbasan, Njësia Administrative Bradashesh, Ish Kombinati Metalurgjik, Zona Kadastrale 3965, Nr Pasurie 1070.* Përshkrim i veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
 - *Menaxhimi i mbetjeve:*
 - ID 5.1.a Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi.*
 - ID 5.1.c Incinerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incinerimi, përveç atij të referuar në pikën 5.1 a*
 - ID 5.3.a. Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përveçincinerimit (5.1.a) ose lëndfillimit (5.2.a).*
 - ID 5.3.d. Asgjësim i mbetjeve jo të rrezikshme me trajtim fiziko – kimik (D9).*
 - ID 5.6.a. Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/ paketimeve ose kontejnerëve në mënyrë që të ripërdoren.*
 - ID 5.10.a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart.*
 - ID 5.10.b. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart*
 - *Veprimtari të tjera:*
 - ID 12.1.b. Incinerimi i mbetjeve patologjike.*
4. Një përshkrim të elementëve të listuara në formularin informues;
5. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së në CD;
6. Konsultimet ndërkuftare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi; *Nuk ka*
7. Autoritetin vendimarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen; *Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, afatet janë sipas Kreut III, pika 10 e VKM nr. 419, datë 25.6.2014 e ndryshuar.*
8. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit; info@akm.gov.al

Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkesi/Përfaqësuesi i shoqërisë

Adrese e-maili



Ervin Meçe

info@ecoriciklim.al

Pasuria nr. 1070, Zona Kadastrale 3965, Metalurgji